



k.B.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE

Nr. 5811 prot.Vlorë, më 17.04 2024

PROJEKT -VENDIM

PËR

**MIRATIMIN E VLERËS FINANCIARE TË DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA
DJEGIA E BANESËS TË ZNJ.SHPRESA BARJAMAJ DHE SHPËRBLIMIN
FINANCIAR NGA ANA E BASHKISË VLORË.**

Këshilli i Bashkisë Vlorë në zbatim të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8 pika 2, neni 9/1 pika b, neni 29/1, neni 54 pika dh ,të ligjit nr.45/2019 datë 18.07.2019 “Për mbrojtjen civile”,në VKM Nr. 329 data 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore” paragrafi III/ë dhe pika 3/a, pasi mori në shqyrtim materialin e përgatitur nga Drejtoria e Mbrojtjes Civile, Drejtoria e Financës dhe Këshilli i Qarkut Vlorë,

VENDOSI:

1.Të miratojë vlerën financiare të dëmeve të shkaktuara nga djegia në banesën e Znj.Shpresa Barjamaj,e ndodhur në lagjen “Isa Boletini”,Rajoni Nr2 Bashkia Vlorë, në datën 22.01.2024, sipas preventivit të hartuar nga ekspertët e Këshillit të Qarkut Vlorë përkatësisht në masën:


A. 104.805 (njëqind e katër mijë e tetëqind e pesë) lekë për punime ndërtimi.
(209.610x50%)

B. 193.484(njëqind e nëntëdhjet e tre mijë e katërqind e tetëdhjet e katër) lekë për mobilje dhe pajisje elektroshtëpiake

- Shpërblimi financiar do të përballohet nga fondi i kushtëzuar i buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile të Bashkisë Vlorë.
- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financë-Buxhetit dhe Drejtoria e Mbrojtjes Civile pranë Bashkisë Vlorë.
- Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015, neni 55 pika .

KRYETAR

ERMAL DREDHA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE

Nr. 5811 prot.

Vlorë, më 17.04 2024

RELACION

PËR

PROJEKT-VENDIMIN “MIRATIMIN E VLERËS FINANCIARE TË DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA DJEGIA NË BANESËN E ZNJ.SHPRESA BARJAMAJ DHE SHPËRBLIMI FINANCIAR NGA ANA E BASHKISË VLORË “

Në zbatim të VKM Nr. 329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”.

Komisioni i Bashkisë Vlorë i ngritur me Urdhërin e Brendshëm Nr.301 datë 08.09.2023 të Kryetarit të Bashkisë Vlorë ,shkoi në banesë për të konstatuar dëmet e shkaktuara nga djegia.

Shpresa Barjamaj në datën 25.01.2024 ka paraqitur kërkesën me Nr1292 prot, për shkak të djegies së banesës e ndodhur në lagjen "Isa Boletini", Rajoni Nr.2, Bashkia Vlorë.

Mbas hartimit të proces-verbalit të konstatimit të gjendjes së banesës në datë 31.01.2024, është vijuar me shkresën përcjellëse me Nr.1292/1 prot, datë 01.03.2024 “Dërgohet dokumentacioni për banesën e djegur të znj.Shpresa Barjamaj” në Këshillin e Qarkut Vlorë për të vazhduar me preventivat e vlerësimit të dëmeve nga komisioni i ekspertëve.

Këshilli i Qarkut Vlorë me shkresën Nr.362/1, datë 21.03.2024 “Dërgim dokumetacioni për banesën e djegur të z.Shpresa Barjamaj” ka dërguar preventivin e hartuar nga komisioni i ekspertëve, nga ku rezulton:

- Vlera e dëmeve në banesën e znj.Shpresa Barjamaj është 298.289 (dyqind e nëntëdhjet e tetë mijë e dyqind e tetëdhjet e nëntë) lekë.

Aktualisht Bashkia Vlorë ka mundësi financiare për të ndihmuar familjet për banesat e djegura.

Për sa më lart i kërkojmë Këshillit të Bashkisë të miratojë vlerën financiare të dëmeve të shkaktuara nga djegia në banesat e znj. Shpresa Barjamaj sipas preventivit të hartuar nga ekspertët e Këshillit të Qarkut Vlorë dhe shpërblimin financiar i cili do të përballohet nga fondi i kushtëzuar i buxhetit të shtetit për Mbrojtjen Civile të Bashkisë Vlorë.

DREJTOR

Adrian Vreshtazi

